

MAHIR DOMI
Dh. S. SHUTERIQI

NJË VËSHTRIM MBI TË FOLMEN SHQIPE TË MANDRICËS 1)

E folmja shqipe e Mandricës, me veçoritë e saj, me fenomenet e ndryshme gjuhësore e dialektore që dalin në te, sidomos me mjaft konservacione që ka, paraqit një interes të veçantë për dialektologjinë shqipe, sidomos për dialektologjinë historike, po ashtu edhe për historinë e gjuhës shqipe. Të dhënat e saj do të jenë një material me vlerë, në mënyrë të veçantë kur do të arrihet të përcaktohet me një farë sigurie koha e shpërnguljes së folësve të saj nga Shqipëria. E folmja, si çdo ishull gjuhësor, çfaq interes edhe për problemin e kontakteve të fuqishme të një gjuhe me gjuhë të tjera dhe të përfundimeve që rrjedhin prej tyre.

Ja disa shënime mbi veçoritë kryesore dhe disa fenomene interesante të kësaj së folmeje.

FONETIKA

§ 1. *Sistemi zanor*. — Bie në sy në sistemin zanor trajtimi i ndryshëm i diftongut «uo». Më të shumtën, ai ka dhënë, si në toskërisht, ua: sua, duartë, grua (edhe: gruva, gruo, gruvë), prua (edhe: pruvo, prru); mua, dua, duall (edhe: duoll, duol), duallnë, (edhe: duollnë, duolltë, duollnë), kërkuanë, muar, muarnë, suall (edhe: suoll), shkruaj (edhe: shkron, shkruoj), u trazua, më martuanë, u shpëtua, u shpëtuanë, i zbuarnë, trazuarë, nuk o t'paguani, etj. Po mjaft dendur është ruajtur *uo*. Kjo është e zakonshme në trajtën e habitores së tanishme, duke u çfaqur në elementin e parë të saj, që vjen nga pjesorja e shkurtër: u gëzuoka, kërkuanë (një herë ndeshet edhe: kërkuanë), martuoka, u martuokan, punuoka, pushuoka, u shtruokan. Ndeshet po ashtu *uo* në trajtën pa mbaresë të vetës së tretë njejës të aoristit, tek foljet që mbarojnë me *ll* dhe *r*, shpesh pranë trajtave me *ua*: duoll, mbuoll, muor (edhe: muar), suoll; në aoristin shumë: luojtnë, mbuoll (për: mbuallnë), u mbluon, më mbluonë (edhe: mbluanë); në ndonjë rast në pjesore: ishtë vluorë, dhe në të tanishmen e mënyrave dëftore e lidhore: shkruoj (edhe: shkruaj), ose në ndonjë trajtë tjetër foljore: shkruonish-të; ti luosh, ai luon, luojmë, luojnë, luoni; në raste të veçanta edhe në fjalë të tjera: buoll, duor (edhe: duartë), kuol (edhe: kvol), muoj, ruoza; të huaj, ishtë tuoj. Më ndonjë rast të rrallë, diftongu i vjetër *uo* del,

1) Këto shënime u shkruan në bazë të materialeve dhe të teksteve të mbledhura në vend nga Dh. Shuteriqi. Shih Dh. S. Shuteriqi, **Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica**, në «Studime Filologjike» Nr. 1, 1965.

si në gegërisht, *ue*: u shuëtnë kandiletë (Përalla, 4, 70), u shuëtkan P4, 15), ose i monoftongizuar në *u*: prru. Me daljen e një *v* epentetike në mes, ndonjëherë bashkë me këtë edhe me dobësimin e elementit të dytë në *ë*, kemi trajta si: *gruvo*, *gruva*, u zgjuvejt / u zgjuejt, *gruvë* / *gruë*, *pruvë*, / *pruë*.

Bashkekzistenca e tërë këtyre varianteve është e një interesi të madh. Një hetim i gjatë dhe i imtë, grumbullimi i një materiali më të madh, do të sqaronte kushtet në të cilat çfaqen këto forma të ndryshme, do të nxirrte në shesh cila prej tyre përdoret më shumë dhe cila më pak, në cilat kategori gramatikore, duke lejuar të bëhen statistika dhe vërejtje përgjithësuese më të përpikta. Mjaftohemi të shënojmë se format e ndryshme të këtij diftongu mund t'i gjesh edhe në gojën e të njëjtit person, ndonjëherë edhe në të njëjtën përrallë a këngë.

Ka dhe mjaft trajta e raste kur *o* nuk del e diftonguar, sado që kushtet janë. Këto trajta mund të jenë përfutur edhe nga analogjia. P.sh.: pagoj, pagojmë, pagojnë, mos pagoj; pranë; (unë) dua, ti dosh, neve domë (për: duam), donë; më mblonë (pranë: më mbluonë), mor (pranë: muor, muar); t'i sosh (për: t'i thuash), soje; nxitorë (për: nxituarë); (unë) lon, po: (ai) luon; (unë) shkron, shkrojmë, shkroni, shkrojnë; (un) blon.

§ 2. Është ruajtur, si në toskërisht, *ye* pa u monoftonguar: (unë) ngjyen, ngjyesh, ngjyen, ngjyemë etj., kërcyeka, u ksyë, u ksyemë, u mbërsyë, pëlqyeka; ndërsa *ie* zakonisht ndihet *je*: mbjell, djella (për: djelli), në ndonjë fjalë *e*; setulla, tertzet, shtatzet. *ye* te folja «pyet» ka dhënë *-jo*: pjot (për: pyet), pjosnë (për: pyetnë). Në një fjalë *ye*-n me kthimin e *y* në *u*, e kemi *ue*, duke dalë në mes edhe një *v* epentetike: kruven (për: kryen).

Në këtë mënyrë, në trajtimin e diftongjeve, e folmja e Mandricës ndryshon nga të folmet shqipe të Ukrainës, ku po ashtu si përgjithësisht në gegërishten e sotme, e në disa kategori fjalësh në fshatin arbëresh Montecilfone të Molises, Itali, ato janë monoftonguar në *u*, *y*, *i*.

§ 3. Zanorja «ë» e *patheksuar* përgjithësisht ruhet mirë, si kur është paratheksore, si kur është pastheksore fundore, po shihet megjithatë edhe një farë lëkundje e saj.

E-ja fundore është mbajtur në fjalët dhe trajtat paroksitone, por ndeshet shumë herë dhe në ato proparoksitone, po ende edhe në fjalë me theksin më përpara: a) në rasat e zhdrejta të lakimit të emrave femërorë të shquar njejës: derënë, ujënë, mëmësë, mullisë; e në rasën kallëzore të emrave mashkullorë: tjufeknë; b) në shumësin e shquar, në trajtat e emërore-kallëzores: emëratë, kandiletë, xharafetë; c) në temën e disa emrave femërorë e mashkullorë me *-r-*: zemërë, qiqërë, sekërë; gjarpërë, dimërë, emërë; ç) në zgjedhimin e foljevet veprorë e pësore në mbaresat e së tanishmes, e së pakryerës dëftore e lidhore, të aoristit (së kryerës së thjeshtë), në habitore e në pjesore: japmë, japnë, shkrojmë, shkojnë, rojmë, rojnë, rahëmë, rahinë; duollmë, duollnë, dilnimë, dilninë, dëftenimë, dëfteninë, binimë, bininë; ritenë, gëzohenë, gëzohenishmë, gëzohenishtë, gëzoheninë; u ksyemë; pakanë; kurdisurë, viezorë, zemborë (= viedhurë, dhëmburë); d) dhe në fjalë të tjera: sipërë, vetëzë etj.

Por të shpesha janë edhe trajtat pa *ë* fundore, në fjalët dhe trajtat proparoksitone, duke u alternuar ndonjëherë në të njëjtën këngë, ka të ngjarë për arsye metrike, trajtat më *ë* fundore dhe ato pa *ë*: mos sërítani heqimetë, heqimet me xharafetë; po kte luhatje e gjejmë edhe në të

folët e përditshëm: klishën, bëkan, sënkan etj. Dalin më shumë të ruajtura ë-të fundore në folklor e më pak në të folmen e përditshme. Herë-herë, ka rënë ë-ja fundore edhe në ndonjë fjalë a trajtë paroksi-tone: ni dit, zjet (për: dhjetë), tertzet e pes, un (më shpesh se «unë») etj.

Ë-ja protonike në ndonjë fjalë është kthyer në i: gjimoi, lishoj.

Në disa fjalë, ë e patheksuar, në pasojë të ndonjë asimilimi vokalik regresiv, ose të një përshtatjeje me bashkëtingëlloren e përparme, është kthyer në u: kupucë, kushtu, kutu, u kuputka; sumundë, jam sumurë (edhe: sëmurë); edhe: kuju (për: këjo), trajtë kjo e fundit dalë duket nga analogjia me trajtën e mashkullores. Po kështu kemi: mundafsh.

Ë e patheksuar, fundore ose jo, herë-herë, ndofta për efekt të ndikimit të sllavishtes, ndihet e: ndajfolja «më» ndihet «me», «shume», «të sëresesh» (për: të thëresësh), e «shesme». Përemri «çë», si te Shqiptarët e Ukrainës, ndihet edhe «çe», edhe «çi».

§ 4. Ë e theksuar është kthyer në i tek trajta foljore si Ulqin, Durrës etj; gjë (për: gjë), tindija (për: tëndeja), djalë, ku mundohet të kemi edhe asimilim vokalik ose formim analogjik, tindet roba.

Një e e mëparme e ndodhur para një hundoreje, zakonisht ndihet si ë: qën, vënt.

§ 5. Vemendje meriton trajtimi i ndryshëm i zanores «y», në evolucionet e së cilës ndihet shumë ndikimi i bullgarishtes.

Ka një fjalë ku është ruajtur y: dyzet, dytë vëllazëra (për: të dy vëllezërit), dyjtën (= të dytin), por edhe: du, dju; bylyk, bylyri (për: brryli), yl, dysHEME, po këto raste të ruajtjes janë të rralla dhe zakonisht y ka evoluar në u, ju, jy, në ndonjë rast në i.

Y ka dhënë u (fenomen i njohur dhe në çamërishtet dhe, pjesërisht, në labërishtet): du, frunish (për: frynte), gjymsënate, jut (për yt), kush (për: qysh), qutet; por më shumë ka dhënë ju: bërjumë, djullë, sjutë, tjufeknë (edhe: tyfek); djumbëzjetë, tju (për: ty);aju, kju, atju (për: aty); në ndonjë rast i, si në çamërishtet e në ndonjë të folme të gegërishtes qendrore: mbill, hikan, sindjuk ose sjinduk; thuhet po ashtu: hipi. Rrallë y ndihet jy: djyljyme, tjtjym (edhe: tytym, tju-tjum), sjyndyk, djymbëzjetë (edhe: djumbëzjetë), kju (edhe: kju), jyt (edhe: jut), çupë.

Edhe këtu e folmja e Mandricës nuk pjek veçse pjesërisht me të folmet shqipe të Ukrainës, që e kanë të ruajtur y-në në trup dhe në fund të fjalës: atje vetëm në fillim kjo fonemë i shtrohet jotizimit dhe kalon në jy ose humb labializimin dhe ndihet si i; po ashtu ndihet si i në një artikullim të pakujdesshëm. (Shih N. V. Kotova, Materiali po albanskoj dialektologii. Albanskie govori Ukraini, në «Yçenie zapiski Instituta Slavjanovedenja Tom XIII, 1956, fq. 258).

§ 6. Në disa fjalë, «o» protonike ka dhënë u: dullap, kullani, duneri (për: ndonjeri), dhe «u» postonike o: bukor, vjezorë (për: vjedhurë), zëmborë. Po ashtu, në disa fjalë, zanorja protonike ka dhënë ë: ngërkojnë / ngarkojnë), prëftaska (/ proftaska), pëstaj (/ pastaj), pës (/ posi), këllon (/ kullon). Ndofta për asimilim, kemi: sëllmë (nga: sillmë).

— Kemi edhe raste të tjera evolucionesh sporadike zanoresh si o > a: mori (pjesëza) > mari; e > o: ngro; ov > u: guatënë.

§ 7. Në të folmen e Mandricës, poashtu siedhe në çamërisht, nuk ndodh kراسي i trajtës së shkurtër të përëmrut vetor në rasën kallzore e më pjesëzën të të lidhores, ose trajtën e shkurtër homonime të përëmrut vetor të vetës së dytë njëjës, rasa dhanore, si ç'ndodh në shqipen e përgjithëshme, po vetëm elizioni i ë: ze këzanë o t'e shtjellë, t'e mar, t'e pres, t'e hamë, o t'e shtjellë, o t'e puduvitë.

§ 8. *Sistemi bashkëtingëllor*. Karakteristike është në të folmen zhdukja nën ndikimin e bullgarishtes, pothuajse e plotë e bashkëtingëlloreve ndërthembore *th* e *dh*, ndryshe nga ç'ndodh në të folmet shqipe të Ukrainës, ku i gjejmë këto dy fonema, në të gjitha pozicionet e vetëm në disa fjalë kthehet *dh* në *d*.

Bashkëtingëllorja *dh* është kthyer në dhëmboren *d* po sidomos në fërshëllyesen *z*: dardë, bardë (dhe: barzë), hudrë, verdë, rodan, spurdik; ardëkan, erda (dhe: erz), i erdur; zëndër, zea (për: dheu), më zëmb zëmbi, zi, (për: dhi), uzë, zgjezë (për: zgjedhë), zesëtundur (dhesë tundur, e tundur e dheut, tërmet); maz, të mëza; zjet, trizet, tetzet e pes, shtatzet e pes; u gëzi; hizem, e hoza, hez, lizkam, lizur, t'e hizni, drize-nish (për: dridhej), za (për: dha), zënka, mbloz; ze, eze (për: edhe).

E shurdhëta përkatëse *th* ka dhënë *s*; rallë dëgjohet *th* e ruajtur; edhe në ato raste, nuk ka plotësisht siguri se u dëgjua saktë: sua, sonj, djasë, dris, sekërë, sikë, Viskuthi (Vithkuqi), sier (për: thier), gjis, gjissej (për: gjithsej); sellë, sarta, kalsër, sonë dhe sojnë (për: thonë), sotë, sa, sanë, sënka, të sosh (për: të thuash), sëret, sëresesh, sëritkan, seri, u ksyë, ksehem, hes, lis (për: lith), rjeska, u sasha (: u thashë). Janë dëgjuar me *th*: ç'o të thosh, ç'thojnë, t'thom, tha, thënkane, thënë, arthka, therkanë, e ndonjë fjalë tjetër, dhe këto, zakonisht, në tregime të bisedës së lirë.

§ 9. Grupet e vjetra të bashkëtingëlloreve *kl* dhe *gl*, po ashtu si në të folnet shqipe të Ukrainës dhe në çamërisht, ruhen ende në mjaft fjalë: klishë, klumësht (ë), shkla, shklirë, shkllërisht; kle, klekam, kleka; klaj; glufënë (për: gjuhënë), glisht-glishëtë, glimb (për: gjemb), glu, dë glatë ze dë gjerë, nglinduni (për: i nginjuri), u nglinmë (për: u ngimë), të nglet (= të ngjet).

§ 10. Një lëngëtore *lj* e vjetër në rrokje fundore që në shqipen e përgjithëshme është palatalizuar më tej dhe ka përfunduar në *j*, këtu, si në çamërisht, pjesërisht në labërisht dhe në të folmet shqipe të Ukrainës, është ruajtur si *l*: bilë, shumë: bilëra, fëmilë, mil(ë), val-i (për: vaj-i). Poashtu thuhet ndëlej (: ndejej).

Janë ruajtur *l*-të e grupeve *lk*, *lg* dhe *lq* të fjalët ulk, dilgon (= dëgjon), holq e të helq.

§ 11. Në ndonjë fjalë, grykorja *k* nuk është palatalizuar në *q* përpara një zanorje të përparme: kershi (edhe: qershi), kush (për: qysh), gërkisht (edhe: gërqisht), po duhen përmendur edhe disa raste të *k* që ka dhënë *q* përpara *e*: greke, kleqe, kleqemi (edhe: klekemi), kleqeni.

Ka ndonjë rast sonorizimi të *k* në *g*: garvan.

§ 12 Hundorja qiellzore *nj* në disa fjalë është kthyer në hundoren *n*, në pasojë, duket, të ndikimit të bullgarishtes, në disa të tjera në *n'*. Kështu me *n* del shumësi i disa emrave: qirin-të, komshin-të, kaikçin-të, cëron; numrori «një» thuhet gjithënjë: ni, nizet, neri (për: njeri), doneri, donera (për: ndonjera), gëneni. Me *n'* del e pakryera e

foljeve: unë ngrihen'ja, shkeln'ja, të shihn'je; dhe në ndonjë rast tjetër si: n'joh, gërqn'je (për: greke).

§ 13. Zakonisht, si në shumë të folme të toskërishtes, shqiptohen me *r* fjalë që në gegërisht shqiptohen me *rr*: bera (për: berra), zjar, të marë, merni, e nxjer.

Bashkëtingëllorja lëngëtore velare *ll* në përgjithësi është ruajtur, po në ndonjë rast ka dhënë *l*: akul (edhe: akull), djela (edhe: djella), yl.

§ 14. Në shumë fjalë që nisin me zanoren *e*, ka dalë një *j* protetike: jerë, jenkas, jelp; jecëni (po edhe: ecën); trajtat e ndryshme të foljes erdh: jerçë (për: erdhshë), jerd, jernë (për: erdhnë), jerdëka (për: ardhëka), jerdhur; po edhe: erz, erdëkan. Fenomeni është i zakonshëm në të folmet shqipe të Ukrainës: jerë, jelp, jegër, jembër, jecën, jendet, jerret. Edhe këtu kemi një ndikim sllav nga bullgarishtja.

Del një *v* epentetike antihiatizuese kryesisht pas një *u*-je në: dyver, gruvo, gruva, gruvë, kruvën, pruvë, u zgjuvejt.

§ 15. Kemi një *h* protetike te «hunazë», dhe rënien e një *h* në fund ose në mes të fjalës te: te sho, t'shom, t'shon; po edhe: e sheh.

Për të vënë re është dalja e një *h* protetike në krye të nyjeve ose dhe të ndonjë fjale tjetër, kur fillojnë me zanore: trupi hi hollë, sënka-hi, hima-hi (për: e ëma) etj., që na kujton fenomenin analog që vrehet te Buzuku dhe Daniel Kortezeja (1638)².

§ 16. Bashkëtingëllorja buzore-dhëmbore *f* është kthyer në *h* tek: hustan, hushëra. Krh, hort, hurrë, gëzoh, të të folmeve shqipe të Ukrainës. Po te «gluhë» kemi edhe *h* > *f*: glufë, xharahetë xharafetë; po kështu *h* > *f* te «toftë» / ftohtë.

Te: ushtroj / vshtroj / vështroj) *v* është bërë *u*. Te: toftë (/ ftohtë), kemi thjeshtimin e grupit bashkëtingëllor *ft* me rënien e *f* nisëtore; po ashtu kemi thjeshtime grupesh bashkëtingëllore me rënie të *ë* së nyjes në fjalët: togli (/ të vogli), toçkërë (/ të voçkërë).

§ 17. Togu *nd-* ka përfunduar zakonisht në *d*, në parafjalët «ndë» dhe «ndër»: vatka dë shtëpi; i erdëka dër mënt. Po në ndonjë rast ndihet edhe *nd-* edhe *n-*: ndë tim vënt, në shi.

§ 18. Si në toskërisht dhe në gegërishten jugore, edhe këtu kemi përgjithësisht shurdhimin e bashkëtingëlloreve të tingullta në fund të fjalës dhe para bashkëtingëlloresh të tjera të shurdhëta: lis (lith), mbles, vënt, arthka etj. Po ka edhe raste kur shurdhimi s'bëhet: hez, zëmb e zëmp etj.

19. Kemi raste sinkopash dhe apokopash te trajtat dhe fjalët: pës (/ posi), papë (edhe: prapë), si (/ përsi, përsëri), pë (/ për), bati (/ bagti).

² Shih Dh. Shuteriqi, Një tekst i panjohur shqip i vitit 1638, në revistën «Nëndori» 1958, 6, fq. 148-154.

MORFOLOGJIA DHE SINTAKSA

Edhe morfologjia e shqipes së Mandricës karakterizohet nga ruajtja e disa trajtave të lashta, sidomos të foljet, po ashtu edhe nga fakte gjuhësore që janë rezultat i ndikimit të bullgarishtes.

§ 20. *Sistemi emëror*. Lidhur me gjininë dhe trajtën e emrave, janë për t'u përmendur: djella dhe djela (për: dielli), pleh-a, shi-ja (për: shiu), krah-a (për: krahu), ze-ja (për: dheu), hi-ja (për: hiri), klumësht-a, zë-ja (për: zëri), tate, tatja, tatjes, tatjen. Në ndryshimin e gjinisë në ndonjë rast duket të ketë lozur rol edhe ndikimi i bullgarishtes. Nuk vihen re emra asnjans. Ka vetëm ndonjë mbeturi si: glishëtë (= gishti). Të shumtën e herës emrat asnjans të lëndës janë bërë femërorë: djasa, mjalta, dulla (për: dylli), uja, gjalpa, drisa (: drithi). Po ashtu kemi ballë-balla.

§ 21 Emrat mashkullorë, në rasën kallëzore njëjës të shquar, kanë trajtën me fundoren *-në*: emërnë, hesapnë, kalnë, këzanë, mahernë, rusnë, tjufeknë, kllëçnë, selamnë, Vasillaqnë, zjarnë etj. Shumë rrallë mund të ndeshësh në ndonjë trajtë me *i* ose *u* anaptike, me fundoret *-inë*, *-unë*: vëndinë, asqerllëkunë.

§ 22. Në shumësin e emrave mund të vihen në dukje disa mënyra formimi e trajta.

Tek emrat femërorë ka shumë përhapje shumësi me *-a*. Me të tillë trajtë dalin edhe shumë emra që në shqipen e përgjithshme kanë po atë trajtë si në njëjës e mbarojnë me *-ë*. Marrin prapashtesën *-a* përgjithësisht emrat femërorë që mbarojnë me *-ë*: ditë dita, kupa, kopsa, luga, opinga, macë maca, tërkuza.

Me *-a* e bëjnë shumësin edhe disa emra mashkullorë që përgjithësisht në toskërisht marrin prapashtesën *-e* si: xhama, qilima, e ndonjë tjetër që në shqip e formon shumësin me *-ë*: gurë.

Mjaft dendur del shumësi me *-ra*, kryesisht të emrat femërorë: baltë baltëra, uzëra, bimëra, bilë bilëra, faqe faqera, hushëra, krushkë krushkëra, milëra, killora, nune nunera, punëra; edhe: leshëra, lumëra, Risto Ristova, djado djadora. Kemi shumësin në *-e* të: heqim heqime, hambar hambare, yl yle, dhe atë me *-nj* të kthyer në *-n* ose të ruajtur të: sua sonj (për: thonj), çëron. Emri *glu* në shumës merr edhe *nj* edhe prapashtesën *-a*: glunja.

Disa emra mashkullorë që mbarojnë me *-i*, e formojnë shumësin me prapashtesën *-nj* të kthyer në *-n*: kaikçi, kaikçintë, komshi komshintë, qirintë; për analogji duket me *ka*, kanë një shumë më *-inj* të kthyer në *-in* dhe emra të tjerë, që zakonisht marrin edhe një prapashtesë tjetër, *-ër*, krushk krushqërin, nun nunërin. Edhe në të folmet shqipe të Ukrainës gjejmë një shumës më *-in'i*: ulk ulkin'i dhe ulqin'i.

Emri «kal» e bën shumësin «kuol» ose «kvol», vëlla «vëllazëra».

§ 23. Përgjithësisht nuk përdoret nyja e përparme përpara emrave, as përpara emrave të rasës gjindore, ka të ngjarë në pasojë të vendosjes së cilësorit dhe të atributit emëror përpara emrit të cilit i referohen: vete mbretit bir, ndë vjetra fshat, ni kuqe mollë argjentë, verës kupë, derrësë (: derrit) mish, kungullit gjellë. Ndonjëherë del e përdorur nyja: ndër të raja çesme, ndër të ngushta sokak, të mëza heqime, të verësë kohë. Pa nyje dalin edhe emrat e ditëve të javës: hëna, mara, mërkura, prëmte, shtuna, djela.

§ 24. *Përemrat*. Te përemrat vetorë për vetën e parë njejës përdoret më shumë trajta «un» se «unë»; në vetën e dytë «tinë» pranë «ti», në rasat e zhdrejta «tju» (për: ty).

Te përemrat pyetës mund të përmenden trajtat «çe», por edhe «çë» e «çi»: çë kam bën? Çë kesh bësh? Çë ishte ai? Çë të sonë? Çë dosh?, dhe përdorimi i trajtës «çar» për «çfarë».

Përemrat dëftorë janë: aj,aju dhe kju,kuju; në rasën dhanore shumë «atyrmet» për «atyre». Përemrat mashkullorë përdoren edhe si femërorë: është ky gruva.

§ 25. *Pronorët na dalin me këto trajta:*

Veta e parë, pronori njejës: *tim* gjaksi (: gjoksi im), *tim* veshë (= veshi im), *timeja* dhe *timja* nun, *timja* baxhanak, *timja* vëlla; *tim*, *timi*: është timi; *timja* a mëmë, t'i thonë *timit* tatë, *times* motër, *times* mëmë; shumë: *timet* bera, *timet* vëllazëra; *timet* motëra. Pronori shumë: *toni* fshat, *toni* djado, nga *toni* vënt, nga *toni* Shqipëria; ndë *tonë* fshat; shumë: *tontë* vëllazëra; *tontë* nunërin, *tontë* baxhanakë, *tontë* djadora.

Veta e dytë, pronori në njejës: *tindi* është, *tindja* mashkulli djalë; *jut* dhe *jut* çupë; shumë: *tindet* vëllazëra, *tindet* roba. Pronori shumë: është *tuoj*.

Si shihet, disa trajta të emërores janë ose kanë dalë nga përgjithësimi i trajtave, në origjinë, të rasave të zhdrejta, gjindore e kallëzore, ose janë riformime analogjike me to: *tim* gjoks, *toni* fshat, *tindi* është, fenomen ky i zakonshëm në gjuhën shqipe, e sidomos në gjuhën e folur të mjaft viseve të Shqipërisë. Riformime analogjike kemi edhe në trajta të tjera: *times* nënë.

Për t'u vënë re janë trajtat e shumësit: *timet*, *tontë*, *tindet*, formime analogjike nga pronorët njejës përkatës: *time*, *tonë*, *tinde*.

Bie në sy përdorimi shpesh i trajtave femërore të pronorit mbiemër në vend të trajtave mashkullore, përzjerje që ndodh edhe në mbiemrat e zakonshëm (po pa një përhapje kaq të madhe sa këtu te pronorët e me një karakter të rastit): *timja* nun, *timja* baxhanak, *timet* vëllazëra, nga *toni* Shqipëria, *tindija* mashkulli djalë, *tindet* vëllazëra.

Pronorët mbiemra, siç shihet, përdoren para emrave të cilëve u referohen, duke qenë në kte pozicion përgjithësisht të lakueshëm, ndërsa emrat të palakueshëm, *times* mëmë, *timen* trim, *temin* emër. Përsa i përket shquarësisë së emrit, kjo përgjithësisht tregohet nga pronori e jo nga trajta e emrit: *timja* nënë, *timja* motër, *times* mëmë, nga *toni* vënt, *tontë* vëllazëra, po ashtu, si në shqipen e përgjithshme, në rastet e përdorimit të pronorit mbiemër para emrit s'del nevoja e përcaktimit me anë të nyjes së sprasme (im vëlla = vëllai im, ime motër, sime motre, time motër). Po në Mandricë, ndryshe nga shqipja e përgjithshme, paradigma e pronorit merr formën e paradigmës së një emri të shquar, si një mbiemër i substantivuar. Për t'u vënë në dukje është edhe fakti se emri në Mandricë zakonisht qëndron i palakueshëm, në trajtën e emërores njejës (: *times* nënë), në vend që të vihet në trajtën e rasës përkatëse. Në ndonjë rast pronori nuk vihet në trajtën e shquar si pritej (: ndë *tonë* fshat), kurse në shembullin «*tim* gjoksi» është emri që vihet në trajtën e shquar.

§ 27. *Foljet*. Foljet më bashkëtingëllore në të tanishmen e dëftores në vetën e parë e të tretë njejës dalin, si në shqipen e përgjithshme,

pa mbaresë, kurse në vetën e dytë njejës përgjithësisht me mbaresën *-ësh*, duke u njejtëzuar trajta e dëftores me ate të lidhores së tanishme përkatëse. Në shumës zakonisht ato marrin mbaresat *-m(ë)*, *-ni*, *n(ë)*, e vetëm shum rrallë ndeshen trajta me zanoren tematike *i*, në mbaresat *-im(ë)*, *-in(ë)* për vetën e parë e të tretë: hap, mbjell, njoh, mar, dal, jap, dremit, mas, ngas, kërcas; | hapësh, mbjellësh, njohësh, mer, japësh, dremit dhe dremitësh, masësh, ngasësh, kërcasësh; | hap, mbjell, njoh, mer, del, jep, dremit, mat, nget, kërcet; | hapmë, mbjellmë; njohmë, marmë, dalmë, japmë, dremitimë, masmë, ngasmë, kërcasmë; | hapni, mbillni, njohni, merni, delni, jepni, dremitni, matni, ngitni, kërcitni; | hapnë, hapni, njohnë, marnë, dalnë, japnë, dremitinë, masnë, ngitinë, kërcasnë.

Shembëlla: Me pak bota janë de hane, me pak dita qitnë, me pak para marnë (= ... më pak dit qitin, më pak para marrin); ashtu ishte bënë plani, të marnë nga nizet të dit; të shohnë, të tjernë; e mbjellmë bostan; t'i japnë, killonë e tjtymit e shesme; presnë zënderë të ngrihetë; zenë të më kaskandisnë. Por edhe: marinë ni çupë; të sërësim priftin; nuk më pjosin — e po në atetregim, pjosnë:

Shihet se te foljet me metafoini në *-e*, në *v.* e dytë e ë tretë njejës e në vetën e dytë shumës, ka vija të ndyshme, shkaktuar nga përgjithësime analogjike, shtrirje trajtash e tjera veprime analogjike ndonjëherë edhe në paradigmen e së njejtës folje. Kështu kemi përgjithësisht metafoininë e *-o-* e *-a-* në *-e-* në vetën e tretë njejës: aju mer, del, jep, nget, kërcet; po edhe: aju njoh; ndërsa jo në vetën e dytë që ka zakonisht trajtën përkatëse të lidhores: japësh, ngasësh, kërcasësh; po kemi edhe: ti mer.

Në vetën e dytë të shumësit gjejmë ndonjëherë trajta me metafoininë në *i-* (ndodh te foljet me zgjerim teme): kërcas, kërcitni, ngas ngitni; po më të shumtën pa te, po vetëm me metafoininë në *-e-* si në vetën përkatëse të njejësit: merni, delni, jepni. Në ndonjë rast trajta e metafoinizuar në *-i* ka kaluar edhe në vetën e tretë: ngitinë.

Te foljet me temë në *-t*, si përgjithësisht në shqip, kjo *t-* është kthyer në *-s* në vetën e parë njejës e shumës e në vetën e tretë shumës: ngas ngasim, mas masmë masnë, kërcas kërcasmë kërcasnë; po ashtu edhe në vetën e dytë njejës që është veta përkatëse e lidhores së tanishme: ngasësh, masësh etj.

Ndonjë folje në bashkëtingëllore, nën ndikimin e foljeve me *-n*, del në njejës me mbaresat *-ën*, *-ësh*, *-ën*: un(ë) hipën, ti hipësh, aju hipën; un(ë) jecën. Folja e parë në shumës del me trajtat: hipimë, hipni, hipinë, pra me trajta me zanore tematike *-i-* në vetën e parë e të tretë, ndryshe nga shumica e foljeve më bashkëtingëllore.

Në foljet sot më *-n* të zgjedhimit të tretë në vetën e parë njejës është përgjithësuar zakonisht trajta me *-n*, duke u bërë një me atë të vetës së tretë: un(ë) punon; un(ë) shkron, blon, ngjyen, dëften, vjen, gjen. Në shumës kemi trajtat e përgjithshme të shqipes me *-jmë*, *-ni*, *-jnë*. Kështu: punon, shkron, dëften, gjen, bën dhe bëj, xallahin, vjen; | punosh, shkrosh, dëftesh, gjesh, ngjyesh, bësh, xallahinë, vish; | punon, shkron, dëften, gjen, ngjyen, bën, xallahin, vjen; | punojmë, shkrojmë, dëftejmë, gjejmë, ngjyejmë, bëjmë, xallahijmë, vijmë; | punoni, shkroni, dëfteni, gjeni, ngjyeni, bëni, xallahini, vini; | punojnë, shkrojnë, dëftejnë, gjejnë, ngjyejnë, bëjnë, xallahijnë, vijnë. Po mjaft herë në vetën e parë njejës gjejmë edhe trajtën e përgjithshme me *-j*: pagoj, bëj.

Veta e dytë njejës edhe këtu, si për gjithë foljet, ka trajtën e vetës përkatëse të së tanishmes lidhore dhe del me mbaresën *-sh*: punosh, bësh etj. E njejta gjë ndodh edhe me foljet me zanore si *pi*, *di*. Kemi këtu një ndikim sllav: nga se gjuhët sllave s'e kanë mënyrën lidhore, janë përzjerë trajtat e kësaj mënyre me të dëftores, po ashtu si ka ndodhur edhe në ndonjë të folme të Shqipërisë në kontakt të vazhdueshëm me gjuhë sllave, si p.sh. në dibranisht: Ku po shkosh?

Foljet me zanore të zgjedhimit të katërt, me përjashtim të vetës së dytë njejës, kanë trajtat e shqipes së përgjithshme: *ri*, *rish*, *ri*, *rimë*, *rini*, *rinë*. Po kështu «*di*».

Për t'u vënë re janë këtu foljet që shkojnë pas kësaj paradigme. Më nj'anë ka folje që kanë mbetur folje më zanore, s'kanë marrë në temën e së tanishmes zgjerimin *-n* e s'kanë kaluar në zgjedhimin e tretë si ka ndodhur në përdorimin më të përgjithshëm të shqipes, si p.sh. un *kla*, *la* (për : *laj*), *mba*, *ble*; në anë tjetër folje nga ato që kanë pasë mbaruar me *-n* po që sot, me rënien e *-n* fundore mbarojnë në shqipen e përgjithshme me zanore, shkojnë në këte të folme pas paradigmes së foljeve me *-n* të zgjedhimit të tretë:

ngrën, *ngrësh*, *ngrën*, *ngrëjmë*, *ngrini*, *ngrejnjë*; *zën*, *zësh*, *zën*, *zëjmë*, *zini*, *zëjnë*, *zejnë* a *zenë*. Si shihet, në vetën e dytë të shumësit kemi trajta me metafoninë në *-i*: *ngrini*, *zini*. Po: un *lë* e *le*, *lësh*, *lë*, *lëmë* a *lemë* etj.

Folja «*fle*» del në formën «*fli*» qoftë nga evolucioni i *ë-së* së theksuar në *-i*, qoftë nga përgjithësimi në të tanishmen i trajtës së metaforizuar në *-i*, dhe shkon pas zgjedhimit të foljeve më zanore: *fli*, *flish*, *fli*, *flinë*, *flinë*, *flini*.

Foljet me *-oj* që në të tanishmen e dëftores e të lidhores e zbërthejnë *-o-në* në diftong në këte të folme e kanë kte zanore të pazbërthyer. Tepër rrallë të kap veshi ndonjë trajtë me zbërthim të *-o-* në *-ua-*, në ndonjë rast në *-uo*. Kështu: un *pagoj*,... *neve pagojmë*; *shkron*, *shkrosh*, *shkron*, *shkrojmë*, *shkroni*, *shkrojnë*; un *lon* a *luon*, *ti luosh*, *aju luon*; *luojmë*, *luoni*, *luojnë*; *dua*, *dosh*, *do*, *domë*, *doni*, *donë*.

Folja «*them*» zgjedhohet kështu: *som*, *sosh*, *sotë*, *sojmë*, *soni*, *sonë* dhe *sojnë*, *ndonjëherë*: *thojnë*.

Te ndonjë folje në bashkëtingëllore, pak a shumë po ashtu si edhe në shqipen e përgjithëshme, në pasojë të ndikimit të foljeve me *-n* është formuar një zgjedhim i përzjerë me mbaresat: *-ën*, *-ën*, *-ën* në njejës, dhe *-imë*, *-ni*, *-inë* në shumës: *hipën*, *hipësh*, *hipën*, *hipimë*, *hipni*, *hipinë*.

Foljet «*kam*» dhe «*jam*» zgjedhohen kështu: *jam*, *je*, *ishtë*, *jemi*, *jeni*, *janë*; *kam*, *kesh*, *ka*, *kemi*, *keni*, *kanë*. Si shihet në vetën e dytë njejës folja e parë ka trajtën e vetë dëftores, ndërsa e dyta atë të lidhores.

§ 28. Si trajtë e së pakryerës është ajo me *n'ja*, veta e dytë njejës me *n'je* për gjithë foljet: unë *hapn'ja*, *ti hapn'je*; *mbilln'ja*, *mern'ja* *njch'nja*, *dremitn'ja*, *dëften'ja*, *ngjyen'ja*, *luon'ja*, *shkron'ja*, *punon'ja*, *xallahin'ja*, *ngrën'ja* *zën'ja*, *flin'ja*, *lin'ja*, *bin'ja* *din'ja*; veta e tretë njejës me mbaresën *-ish*: *hapish*, *mbillish*, *jepish*, *merish*, *njohish*, *dremitish*, *klanish*, *dëftenish*, *ngjyenish*, *luonish*, *shkronish*, *punonish*,

xallahinish, lanish, zënish, ngrënish, linish, binish, dinish, flinish, sonish, venish; në ndonjë rast me *-esh*: hem llotëronesh, hem këndonesh.

Në vetën e parë dhe në vetën e tretë shumës, përdoren trajtat me *-imë*, *-inë* ose *-jimë*, *-jinë*, si fundore për foljet më bashktingëllore, (duke mos dalë *n'* e dy vetave të para të njëjësit), e me *-nimë*, *-ninë*, për foljet me *n* e për ato më zanore: mbillimë, mbillinë; hapjimë, hapjinë; njohimë, njohinë; dremit(jimë, dremit(j)inë; matimë matinë; ngitimë, ngitinë: lanimë, laninë; dëftnimë, dëfteninë; luonimë, luoninë; punonimë, punoninë; shkronimë, shkroninë, binimë bininë. Por edhe: dilninë.

Veta e dytë e shumësit ka mbaresën *-ishtë* te foljet më bashkëtingëllore e mbaron me *-nishtë* te foljet më *n* a më zanore: juve hapishtë, mbillishtë, jepishtë, merishtë, dremitishtë, matishtë, ngitishtë; lanishtë, klanishtë, pūnonishtë, shkruonishtë e shkronishtë, dëftenishtë, ngjyenishtë, ngrënishtë, zënishtë, linishtë, binishtë, dinishtë, rinishtë.

Si duket në analogji me vetën e dytë, janë krijuar për vetën e parë dhe të tretë shumës edhe trajta me fundoret *-ishmë* ose *-ishimë*, përkatësisht *-ishnë* ose *-ishinë* e foljet më bashkëtingëllore dhe me fundore *-nishmë*, *-nishnë* dhe *-nishninë* te foljet më *-n* a më zanore: neve dremitishmë, jepishinë pranë jepinë, njohishnë, jecënishnë, klanishmë, shkronishmë; binishnë pranë bininë, flinishmë, dinishmë, linishmë, zënishmë, rinishmë. Më të shumtën e herës ndodh që për të njëjtën folje në vetën e parë shumës të përdoret një trajtë me *-sh*, ndërsa në të tretën të përdoret trajta e zakonshme, rrallë anasjelltas: dinishmë, dinishtë, dininë; shkronimë, shkronishtë, shkronishmë. Ka edhe raste kur trajtat me *-sh* janë përgjithësuar për gjithë vetat e shumësit: xallahishmë, xallahishtë, xallahishnë. Për t'u vënë në dukje është se kjo folje e një folje tjetër në *-in* si ajo, ndërsa në njëjës e kanë *n*, në shumës nuk e kanë dhe dalin jo me fundoret *-nishmë*, *-nishtë*, *nishmë* si foljet e tjera më zanore a më *-n*, po me fundoret *-ishmë*, *-ishtë*, *-ishnë*: blanirishnë qengjetë.

Tek foljet që në të pakryerën përgjithësisht në shqipet dalin me trajta të metafonizuara në *-i-*, këtu kemi zakonisht trajta me metafoini, po herë herë vetëm me metafoininë në *-e*, ndonjëherë pa metafoininë fare: mbilln'ja ngitn'ja, lin'ja (folja le, lë); mern'ja; jipn'ja, tinë jepn'je; njohn'ja.

Foljet «kam» dhe «jam» dalin me kto trajta: kisha, kishe, kish, kishmë, kishtë, kishnë; unë isha, tine jesh, ato ishnë, edhe me trajtën e aoristit «klesha».

Ndonjëherë e për disa folje, për të pakryerën përdoret trajta e së kryerës së thjeshtë, e aoristit: vjen, e pakryera jerça, jerçe, jertz ose erz, jermë, jertë jernë; dua desha. Kemi këtu pasojën e një ndikimi të bullgarishtes me qenë se në gjuhët sllave ekziston një trajtë e vetme foljore për kohët e kaluara.

Është ndeshur një rast i së pakryerës me *-sh* që të kujton të pakryerën sekondare të gegërishtes së sotme: nuk i ngitshinë (pranë: i ngitinë), po duke pasur para sysh ç'u tha më sipër për formimin e fundoreve *-ishmë*, *-ishnë* nga analogjia me fundoren e vetës së dytë shumës, kjo mund të spjegohet edhe si e ardhur nga forma e sipërpërmendur me *-ishnë*.

§ 29. Ka përdorim shumë të dëndur, te foljet vokalike, aoristi me -t: ëndërita, punojta; gënejti, këcejti, shkojti, shpëtojti, shtrojti, mbrejti, ushqejti, këndojti, vlojtnë; në vetvetore mesore: u zgjuvejt (për: u zgjua), u gëzit (për: u gëdhi), u shuëtnë. Po kështu e bën aoristin edhe ndonjë folje me -t, me temë të parë në zanore: ngati. Ja zgjedhimi i një aoristi me ta: punojta, punojte, punojti, punojtmë, punojttë, punojtnë.

Ka dhe raste të aoristit sigmatik me -sh-. Veta e parë ka mbaresën -a, e dyta -e, gjithë duke ruajtur sh: klesha, kur i zasha (për: i dhashë) zjarnë; lasha, rasha, thasha, mbetsha, jerça; lashe, jerçe, rashe, kleshe. Veta e tretë e njejësit dhe vetat e shumësit, si në gjithë shqipen, janë pa -sh: kle, klemë, kletë, klenë; la, lamë, latë, lamë.

Përdorim më të gjerë aoristi sigmatik ka në pësore-vetvetore: (unë) u gëzuosh, (ti) u gëzuoshe; u lakça. Ja zgjedhimi i një aoristi sigmatik pësor: u sasha, u sashe, u sa, u samë, u satë, u sanë. Në vetën e parë njejës ndonjëherë, në pësore-vetvetore, mbaresa është zero: u gëzuosh.

Në aoristin asigmatik, te foljet që mbarojnë me bashkëtingëlloret lëngëtore l, ll, r, në vetën e tretë njejës, jo vetëm në pësore-vetvetore, por edhe në veprorë, del rregullisht trajta pa mbaresë: nuk i mor, muar, më muar kaikçiu: duoll, duall; suoll. Edhe: vat (për: vajti). Po ndeshet ndonjëherë edhe ndonjë trajtë me mbaresën -i: mbolli:

Në shumës mbaresat janë -më, -të, -në: më mblonë e më mbluanë, jertë, jernë (për: erdhnë), vlojtnë.

Te foljet në -l, -ll me apofoni në aorist, në vetën e parë e të dytë njejës kemi trajtë me o të pazbërthyer në diftong, pse kjo ndodhet në rrokje të hapët, ndërsa në vetën e tretë njejës zakonisht dhe në vetat e shumësit kemi trajta me zbërthim në diftongun uo: dolla, dolle, duoll, duollmë, duolltë, duollnë; mbolla, mbolli, mbuoll ose mbolli, mbuollmë, mbuolltë, mbuollni.

Folja «vdes» ka një aorist me përgjithësim të temës të së tanishmes: aj vdesi.

§ 30. Lidhorja e tanishme përdoret edhe me lidhëz -pjesëzën të dhe pa të: t'e pres, t'e hamë, kush t'e shtroj; kur shohësh me bardë kalë... të më ngrësh; kur bjerë shi; kur shkojë bletha, o t'i puda-vitë.

Veta e dytë njejës e lidhores së tanishme del me mbaresën -sh, te foljet më bashkëtingëllore zakonisht me ë- si zanore tematike, në ndonjë rast të rallë me -i- (: ti mbjellësh, dremitësh, shohësh, ngasësh, masësh, presësh, hapish dhe hapësh): te foljet me -n pa -j- me të cilën del përgjithësisht në toskërisht (: punosh, dëftesh, ngjyesh, lash) rrallë me j: t'vejsh.

Veta e tretë njejës ka mbaresën ë duke dalë si në shqipen e përgjithshme, një -j- epentetike antihiatizuese te foljet, në origjinë, më zanore, por mbaresa ë te këto herë herë ka rënë: t'dalë, të marë, të dremitë, të perëndojë, shkojë, mos hajë, të haj.

Foljet «them», «vete», «bie» bëjnë në kte vetë: të sojë dhe t'sojë (urdhërorja: soje, për: thuaje), të vejë, të bjerë.

Foljet «kam» dhe «jam» zgjedhohen kështu në kte kohë: të jam, të je, të ishtë, të jemi, të jeni, të janë (si shihet përdoren trajtat e dëftores); të kam dhe të kem, të kesh, të kaj, të kemi, të keni, të

kanë. Te folja «kam» përdoren të përziera trajta të dëftores e të lidhores; nga veta e tretë e shumësit «kanë» është formuar analogjikisht siç duket veta e tretë e njëjësit «kaj».

§ 31. Forma të zakonshme të së ardhëshmes dëftore dhe të kushtores janë ato me pjesëzën *do* të reduktuar në *o* (poashtu si në disa të folme të toskërishtes) të bashkuar me lidhoren e tanishme, përkatësisht të pakryer: këzanet *o t'i pagëzosh*; sefte sanë që *o t'bëjnë kooperativë*; un *o t'e mar*, aj *o t'të haj*; *o t'lishoni berat*; nuk *o t'vemë*, nuk *o t'veni*, *o t'vejsh* dhe klishë, *o të jam*, *o të kam*. Ndeshet ndonjëherë edhe trajta e formuar prej foljes «kam» dhe lidhores, trajtë që është e zakonshme në arbërishten e Italisë: S'ka të shkosh donjëherë **dë Bullgari**. Edhe të folmet shqipe të Ukrainës përdorin për të ardhshmen një trajtë analoge: un *ot (o t')* shkrun, ti *ot shkruanësh*, aju *ot shkrunë*.

§ 32. Për t'u vënë në dukje është një trajtë analitike e veçantë e përdorur për kushtoren e tanishme, formuar nga e tanishmja e lidhores prirë nga pjesëza e pandryshueshme «qosh»: qosh punon, qosh punosh, qosh punojë, qosh punojmë, qosh punoni, qosh punojnë; un qosh *la* (për: unë *do të laja*); un qosh *sahem*, un qosh *gëzohem*.

§ 33. Përdorim shumë të dendur ka habitorja e tanishme me vlerën e një të tanishmeje dëftore historike, në vend të aoristit. Si në të folmet shqipe të Ukrainës, është trajta kohore e zakonshme e tregimeve. P.sh. Ni kohë, ni dalë u vloka dhe jatër fshat, dhe Gjushqunar. Ni dit rënka shumë shi. U niska dhe mëhallë aju. Kur vatka, qit robotë, bëhet gollapar... Zëndëri, kur vatka dhe shtëpi, vesh robotë jashtë. Kur hika brënda, nusja e ngatka kushtu, mos ishte lagëta: aju s'paska lagëtë. Nusja sënka... (Përrallë).

Foljet më *-oj* çfaqin trajta të ndryshme. Pjesa e parë, që, si dihet, vjen nga pjesorja pa mbaresë e foljes, del më të shumtën me *-uo-* (martuoka; u martuokan, kërkuoka, punuoka, u gëzuoka, pushuoka, ushtruokanë), ndonjëherë me *-o-* të pazbërthyer (mësoka, vloka, u ndroka). Trajta të habitores për folje të tjera: prekan, jerdëkan dhe erkan (për: erdhëkan), erthka, sënka, serkanë, sëritkanë, vatka vatkanë; hëngërkan, ndjetkan, dashka, shpuka.

Për t'u vënë në dukje është qenia e një trajte të habitores me t të shtuar, sidomos te foljet më *-oj*: shkotkan, ushtrotkan, shuetkan krrh.: «*penojtkam*» të të folmen shqipe të Ukrainës); edhe: ngatka (për foljen «ngas»).

Herë-herë del trajta me *-j-*, në analogji, duket, me vetën e parë njëjës të së tanishmes dëftore: ngërkojkan, mbajka; ose me *j* dhe me *t* njëkohësisht, duket për analogji me temën e aoristit: lishojtkan, zjetkan; ose me *-n-* dhe *-t-* për analogji me trajtat e së tanishmes e të aoristit njëkohësisht: mentonka.

Në vetën e tretë njëjës gjejmë ndonjëherë trajta me fundoren *-kaj* pranë asaj me *-ka*: zënkaj e zënka.

Foljet me pjesoren me *në* kanë në habitore zakonisht trajta pa *n* në pjesën e parë: klekan, vëka; zëka; rrallë trajta me *n(ë)*: rënka, zënka, thënkkan.

Foljet «jam» dhe «kam» zgjedhohen kështu në habitoren e tanishme klekam, kleqe, kleka, kleqemi, kleqeni, klekan; paskam, paskam, paka.

§ 34. Në pjesore foljet me zanore dalin në trajtën me prapashtesën *-rë*: larë, punuarë; foljet me bashkëtingëllore në trajtën me prapashtesën *-ur(ë)*: dremiturë, hapurë; ato me bashkëtingëllore lëngëtore dalin në trajtën me *-ë*- si prapashtesë: mbjellë. Në mjaft raste, duke u formuar në bazë të aoristit më *-ta* ose për analogji me të, pjesorja del me fundoren *-tur*: (ka) martur (për: marrë), këndojtur, shkrojtur, mbylltur. Ja trajta e pjesores për ndonjë folje tjetër: u ka bënë, ka vdesur.

§ 35. Në zgjedhimin pësor vetvetor në të tanishmen e dëftores kemi fundoret e trajtave të përgjithshme të shqipes *-em*, *-esh* etj. për foljet me bashkëtingëllore, dhe, me *-h-* epentike antihiatizuese për foljet më zanore, *-hem*, *-hesh* etj.: hizem, lizem, gëzohem, kshem; hizesh, . . ., hizemi.

E pakryera del me fundoret: *-en-ja*, *en'je*, *-enish*, *-enishmë*, *-enish-të*, *-eninë*, për foljet më bashkëtingëllore, dhe, duke dalë një *-h-* epentike antihiatizuese, me *-hen'ja*, *-hen'je*, *-nish*, *-henishmë*, *-henishtë*, *-heninë*. P.sh. hizen'ja, hizen'je, hizenish, hizenishmë, hizenishtë, hizeninë; gëzohen'ja, gëzohen'je, gëzohenish, gëzohenishnë, gëzohenishtë, gëzoheshinë.

Aoristi, habitorja, urdhërorja formohen, si në shqipen e përgjithshme, nga trajta përkatëse e veprores prirë nga pjesëza përemërore vetvetore *u*: u sasha, u sa, u hoza; u gëzuokam, u gëzuokeni.

Trajtat në kohët e quajtura të përbëra në zgjedhimin pësor-vetvetor formohen, si përgjithësisht në shqip, me ndihmëtarin «jam». Po ka edhe raste të formimit nga trajta përkatëse e veprores me pjesëzën përemërore *u* përpara: u ka bënë.

§ 36. Si trajtë e shprehjes me vlerë paskajorje «për+te+pjesore» përdoret edhe trajta «për+pjesoren»: për vjezurë, për ngrënë.

§ 37. *Ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat*. Ndër ndajfoljet mund të përmenden trajtat «tashi» e «nashti», «pëstaja» e «pëstajë» (për «pastaj»), «djesna» (= djethinaj, dje). Pjesëza mohuese «nuk» del në format «nuku» e «nukë». Ka përdorim të shpeshë trajta «sun» për «s'mund» s'un të jecën.

Parafjala *ndë/në* përdoret zakonisht në formën *dë* me rasën emërore të shquar të emrit: *dë guri*, *verë . . . dë kali*, *verë . . . dë brezi*; *herë herë* me kallëzoren e pashquar: *dë Sofje*, *dë vreshtë*, *ngrihen'ja un dë qiellitë*. Me përemrat merr rasën kallëzore: *t'vini prapë dë mua*.

Parafjala *ndër* po ashtu përdoret në formën *dër*, ndërtuar me rasën kallëzore. Parafjala *për* del edhe në formën *pë*.

§ 38. *Formimi i fjalëve*. Në formim emrash veprimi a gjendjeje nga pjesore, kjo s'del në formën e një mbiemri asnjans të nyjësuar si në shqipen e përgjithshme, po pa nyje, në përshtatje me fenomenin e zakonshëm të mos çfaqjes së nyjës së përparme në kte të folme: *kruves zëmborë* (= të dhembur krei), *dhesëtundur* (= të tundur dheu).

Për t'u përmendur janë trajtat me enklitiken *-në*: *tinë*, *këtenë*, *kutunë*. Ndeshet prapashtesa hipokoristike *-zë*: *djemëza* *djemtëza*, *vetëzë*, poashtu prapashtesa *-kë* me kuptim zvogëlimi: *copkë*.

§ 39. Nga errësimi i ndijës gjuhësore, në përshtatje të mbiemrave përzjehen gjinia mashkullore me femëroren, ndonjëherë edhe shumësi me njëjësin, duke marrë një emër i gjinisë mashkullore një mbiemër të trajtës femërore dhe, anasjelltasi, një emër i njëjësit një mbiemër në trajtë të shumësit: *ai ditë*, *ai kupucë*, *ai çupë*, *imja shpirt*.

kuqen kalë, tëncija mashkulli fjalë, u bëka maze fshati, toni zendër shumë mëncime; ndë vjetra fshat, në të ngushta sokak.

§ 40. Atributët, qofshin mbiemra, qofshin emra në gjindore, vendosen përpara emrit a për emrit që përcaktojnë. E njëjta gjë ndodh zakonisht edhe në të folmet shqipe të Ukrainës. Kemi këtu një ndikim të bullgarishtes. Ja disa shembëlla: veremit sëmundë, barkut zëmborë (= të dhëmbur e barkut), qengjës mish, verës kupë, rakisë kupë, kruves zëmborë (= të dhëmbur krei), djellës lule (= lule dielli), kungullit gjellë, kalit kullanë, për çorbaxhiut çupë, të verës kohë; vjetërë verë, kalsërë flakë, gjelbërë flakë, ndë vjetëra fshat, ndë të ngushta sokak, mëndafshhtë testembel; tim veshë, time qafë.

§ 41. Në sintaksë për t'u përmendur është edhe ndërtimi i fjalive qëllimore me një trajtë foljore të formuar nga lidhorja prirë nga parafjala për, dalë duket nga kontaminimi i dy mënyrave të zakonshme të shprehjes së fjalive qëllimore, me lidhoren dhe me shprehjen me vlerë paskajoreje «për + pjesoren e substantivuar asnjandëse me nyjë» (: shkoj të thëres mjekun, shkoj për të thirur mjekun). Shembëlla: tatja e bëka konaknë për t'i japmë konak; turketë ndejtkan për të hanë bukë (Kënga 4a);... për të mund të rri...; për të mund merni uzë. E njëjta formë dhe i njëjti ndërtim dalin edhe në arbërishten e Greqisë (: bëri të fjeturin, për të shih çë do t'apobënej; i shkruajmë këto për të dëftojmë; shih A. Xhuvani, Studime gjuhësore, fq. 24), po ashtu edhe në fshatrat arbëreshe të Molises: E pë-t pëskuor dish veja te lumi (= e për të peshkuar doja të veja te lumi). Vinja prapa për të bëja shok. Shih A. Cirese, Canti popolari delle colonie albanesi del Molise, Rienti 1958, f. 18,24). Ndeshet edhe në të folmen e fshatit Muzinë pranë Delvinës: kam edhe tjetër për t'i jap (M. Totoni, E folmja e Muzinës).

§ 42. Në të folmen e Mandricës kanë hyrë edhe mjete dhe trajta gramatikore nga bullgarishtja. Kështu përdoret pjesëza pyetëse *li*: Vërtet-li? Nukë-li gjegjesh?

Në sistemin emëror, në rasën thirrore, pranë trajtave të zakonshme me -o ose pa mbaresë, përdoren herë herë trajta me pjesëzat *lo*, *le* enklitike nga trajtat përkatëse të bullgarishtes: Mate-le, mari bukorë nuk të vjen keq, Mate..? — Ze të më vij keq, mëmo-lo, kollaj nuk ha, mëmo, Dimço-lo, biro-lo, Dimçolo, nukë-li gjigjesh; biro-lo...?

Foljet vetvetore marrin shpesh në mënyrë enklitike -si që vjen nga *se* e zgjedhimit vetvetor të bullgarishtes. Por këtë e gjejmë, përveç kësaj, edhe me folje veprare moskalimtare, por edhe kalimtare. P.sh. zagaçitsi, gjigjemi, u sëmursi; mbiusi, rënkasi, vetesi, vatkesi; berisi, hapnësi, shpunësi, qitnisi, të sërëtsi, meresi, mblonësi. Në ndonjë rast të rrallë, ky element i është ngjitur edhe ndonjë fjale jo foljore: kuqesi, ngrotsi, lartsi.

Përdoren shpesh për emrat *hi* për njëjës, *him* për shumës, nga për emrat bullgare trajtë e shkurtër -i (= asaj) dhe *him* (= atyre): Nga poshtë vinë, Stano, tri turke me tri robinka. Për konak pjosnë, Stano; t'i japmëhim-li konak Stano. Stano i sa-him (= u tha). Trajta *hi* përdoret edhe për gjininë mashkullore, po ashtu ndonjëherë edhe për shumës: Pa i sënka-hi (= pa i thënka), i laka-hi, i sënka-him. Këto trajta të shkurtëra për emri i gjejmë edhe me emrat për të dhënë idenë e përkatësisë: hima-hi = e ëma e saj, tat-hi = babai i saj; po ashtu edhe: mëmti = mëma jote.

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

§ 43. Po t'i hedhim një sy të përgjithshëm së folmes vemë re se: 1) ka një numër të mirë konservacionesh kryesisht në fonetikë; 2) përgjithësisht trajta jo aqë të lashta në morfologji; 3) ndikime të ambientit gjuhësor të ri në te dhe inovacione në kte truall të ri.

E folmja ka ruajtur në pjesë të mirë diftongun e vjetër *-uo*, përgjithësisht *-ë-në* fundore edhe në fjalët e trajtat proparoksite, nuk bën krasin me trajtën e shkurtër të përemrit vetor *e*, ka mbajtur në shumë fjalë grupet e bashkëtingëlloreve *kl* e *gl*; ka kallëzoren më mbaresën *-në*, e te foljet trajtat e së tanishmes dëftore e lidhore pa zanoren e sotme tematike *-i*; mjaft folje me zanore pa kaluar në folje me *-n*.

Te përemrat pronorë kemi mjaft përdorime trajtash sekundare me përgjithësim analogjik të një trajte a riformime analogjike, të foljet me zanore a *n* në të tanishmen e dëftores e të lidhores trajtat e sotme të përgjithshme të shqipes me *j* të dala nga zhvillimi i mëtejshëm i trajtave më të vjetra me *një* (punojmë / punojmë / punonjë-më), s'ka gjurma të së pakryerës më të lashtë te foljet «jam» e «kam» (: keshë, jeshë) që e gjejmë ende sot në disa të folme të toskërishtes.

Në të folmen ka edhe një sërë inovacionesh të veçanta, pasojë qoftë e zhvillimit të mbrendshëm, qoftë e rrethit gjuhësor sllav. Të kategorisë së parë mund të jenë mbaresa *-ish* për vetën e tretë njejës dhe mbaresat, duket të lidhura me ktë, të shumësit *-ishmë*, *-ishtë*, *-ishnë*. Bullgarishtja ka ndikuar në sistemin fonetik me humbjen pothuajse të plotë të bashkëtingëlloreve ndërthembore *dh* e *th*, me daljen e një *j* protetike para një *e* fillestare, me kalimin e pjesëshëm të *y* në *ju*, *ju*, të *nj* në shumësin me *-inj* në *-in*, në përdorimin ndonjëherë të trajtës të së pakryerës edhe me vlerën e aoristit ose anasjelltas, me përdorimin e trajtës së lidhores së tanishme në vend të dëftores e anasjelltas, me humbjen e ndjenjës gjuhësore shqipe ndonjëherë në trajtat emërore lidhur me gjininë e me numrin, nga vendosja e atributit, qoftë emër, qoftë emër në gjindore, para emrit përkatës, përveç ndonjë mjeti gramatikor, si ata që u përmendëm, që i ka dhënë.

§ 44. A na jep gjuha elemente të mjafta për të hedhur dritë mbi çështjen se nga ç'treve e Shqipërisë e kur u shkulën themeluesit e këtij fshati? Për të thënë një fjalë pak a shumë të sigurtë, do të duhej një material më i plotë, e t'i shtrohej ai një krahasimi sistematik me materialin e të folmeve të ndryshme të Shqipërisë. Tani për tani mund të bëhet ndonjë konstatim e të hidhet ndonjë hipotezë, hipotezë pune më tepër, që mbetet për t'u kontrolluar e për t'u vërtetuar me kërkime të mëtejshme.

Mjaft tipare e fenomene të së folmes të shpien në veçori të zonës së Korçës e pikërisht të Devollit (parafjalët *ndë*, *ndër* përfunduar në *dë* e *dër*, trajtat e shumësit në të tanishmen e dëftores e të lidhores pa zanoren tematike *-i*, në Devoll: ngasëm, ngasën, në Mandricë: hapmë, mbjellmë, gjasësisht nga hapëmë, mbjellëmë; përdorimi i dendur i shumësit të emrave në *-ra* dhe i aoristit në *-ta*, disa trajta të përemrit pronor shumë, në Devoll: gjishtrinjt tem, duart time, duart tënde, në Mandricë: timet vëllazëra, tëndet roba; shumica e trajtave të së pakryerës të foljeve «kam» dhe «jam»: në Devoll: kisha, kishe, kish,

kishim dhe kishmë, kishit, kishin dhe kishnë; isha, ishim, a ishnë, në Mandricë: kisha, kisha, kish, kishmë, kishitë, kishnë¹) e ndonjë tjetër. Duhet shtuar se tiparet e elementet kyesorë arkaikë të së folmes së Mandricës kanë qenë të gjalla gjer tani vonë në një pjesë të Devollit, në Dardhë, Sinicë, Qytezë, e kemi fjalën për konservimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl, lk*, për ruajtjen pjesërisht të diftongut *uo*. Mund të shtohet se fenomeni i daljes së një *v* epentike në Mandricë pas *u-së*, në ndonjë rast të rrallë pas *y-së* (gruvo, gruva, gruvë, pruvë, u zgjuvejt, dyver) shihet edhe në Dardhë, ku janë ndjerë kryesisht te mosha e vjetër; *çkruwa* (me një *v* dybuzore), *gruwa* etj.

Këto të dhëna të shpien pak a shumë po në ato anë ku të shpie gojëdhëna. Si është thënë në studimin Dh. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica* (Studime Filologjike 1965, nr.1) mandricarët mbahen të ardhur nga Vithkuqi e nga anët e Korçës, ndërsa fshatrat e afërta shqiptare përtej kufirit si Ibrik Tepeja a Qyteza e Fan Nolit, nga Kolonja. Dardha, Sinica s'janë larg nga Vithkuqi, e ngjitur me Kolonjën. Tiparet e pjesëshme arkaikë janë kështu konservacione të një zone malore të ruajtura edhe në Shqipëri gjer vonë, ndërsa gjuha në tërësinë e saj nuk të jep një fazë aqë arkaikë të shqipes. Prandaj shpërngulja është e këtyre shekujve të fundit, gjë që përforcon përfundimet e arritura në studimin e sipërpërmendur.

Ndonjë element i rrallë, që të kujton gegërishten (raste të diftongut *ue* ose të monoftongizimit në *u*, forma si *çar, nashti, s'un*) mund të vijë nga fakti se në popullsinë e këtij fshati janë të përzier edhe të ardhur nga Shqipëria e Mesme. Studjuesi bullgar Jaranov thotë se që nga shekujt XV-XVI gjer në shekullin e XIX ka pasë shpërngulje për në Maqedoninë lindore, Traki, Mizi, jo vetëm nga krahina e Korçës, por edhe nga ato të Elbasanit e Dibrës²).

1) Shih J. Gjinari, **Mbi të folmen e Devollit**, në «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore» 1960, 4, fq. 103-131 dhe V. Xhaçka, **Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit**, po aty 1958, 2.

2) D. Jaranov, **Preselničesko dvizhenie na Bëllgari ot Makedonia i Albania këm istoçnite bëllgarski zemli prez XV do XIX vek**, në «Makedonski pregled», Sofia, VIII, 1931, f. 63-118, sipas S. Islami, **Material gjuhësor i kolonive shqiptare të Ukrainës**, në «Bul. për Shk. Shoq. 1955, 2, fq. 164.

R é s u m é

BREF APERÇU DU PARLER ALBANAIS DE MANDRICA
(BULGARIE)

Il y est donné un rapide aperçu du parler albanais de Mandrica, un village d'environ 200 familles, situé dans le district d'Ivajlovgrad, à la frontière bulgare-turco-grecque. Il a fait partie d'une groupe de huit villages albanais de la région d'Adrianople, dont 7 sont restés en territoire turc, après la nouvelle délimitation des frontières en 1913, et Mandrica en territoire bulgare.

Dans l'article de Dh. S. Shuteriqi, publié dans le premier numéro de cette année de notre revue, avaient été donnés les renseignements généraux sur cette colonie albanaise, (avec des hypothèses sur l'origine de ses premiers habitants et de leur installation ici) et un certain nombre de textes de ce parler, chants, contes et des récits sur la fondation du village et sa vie actuelle, recueillis sur place par l'auteur en septembre 1959. Plus loin, dans la rubrique «Documents et Matériaux», sera publié un petit glossaire de ce parler.

Ici on a visé à faire connaître les traits et les phénomènes particuliers et intéressants de l'albanais parlé encore par cet îlot linguistique. Il intéresse la dialectologie, surtout la dialectologie historique, et l'histoire de la langue albanaise, par maints archaïsmes et autres faits linguistiques, aussi bien que la linguistique générale par les résultats qu'on y peut observer de l'action d'une langue sur une autre dans les circonstances d'un contact intense.

